

Data 04/08/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Punime mbrojtje të kaptazhit NR. 2 Rrëshen

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45247130-0 Punime ndertimi për ujësjellës.

VLERA E FONDIT LIMIT:

2,692,377.7 (dy milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dymijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë shtatë) lekë pa TVSH .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2,, shkronja “c” dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë Sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen e mëposhtme.

Bazuar në nenin 4, pika 5, të ligjit nr. 162/2020, si dhe nenin 14 të vendimit nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, autoritetit kontraktor ka përdorur dokumentet e tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP) me vendimin nr. 3, datë 09.06.2021 “Për miratimin e dokumenteve standarde të tenderit për mallra, punë dhe shërbime, për procedurën e prokurimit, procedurë e hapur e thjeshtuar”.

Po kështu, lidhur me përmbajtjen e dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor iu referua nenit 74 të ligjit nr. 162/2020 dhe neneve 14 e në vijim, të rregullave të prokurimit publik. Duke qenë se kishim të bënim me punë publike, autoriteti kontraktor mori në konsideratë nenin 39 të rregullave të prokurimit publik gjithashtu dhe nenin 55 të këtyre rregullave sa i takon llojit të procedurës së prokurimit publik. Në dokumentet e tenderit nuk është përdorur njoftimi paraprak.

Në dokumentet standarde të tenderit është përcaktuar edhe kohëzgjatja e kontratës në masën prej 30 ditësh pune, brenda të cilës do të realizohen punimet.

Gjithashtu, është saktësuar se, në këtë rast kemi të bëjmë me një procedurë prokurimi, fondet e të cilës vijnë nga buxheti i shtetit. Është bërë shënimi përkatës se procedura nuk ndahet në lote, pasi në këtë rast kemi të bëjmë vetëm me një shërbim të ofruar prej një operatori ekonomik dhe jo disa shërbime të lidhura me njëra-tjetrën me natyrë komplekse. Po ashtu, është saktësuar se, nuk do të pranohen variantet dhe nuk do të pranohet nënkontraktimi, si dhe nuk do të pranohet mbështetja tek subjektet e tjera. Procedura e prokurimit shpallet për herë të parë.

Në dokumentet e tenderit është parashikuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin sigurimin e ofertës në masën 2% të vlerës së kontratës sipas nenit 83 të ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 30 të rregullave të prokurimit publik në shumën monetare prej 53.848 (pesëdhjetë e tremijë e tetëqind e dyzet e tetë) lekësh. Sigurimi i ofertës mund të bëhet në llogarinë bankare të shoqërisë, me garanci bankare ose përmes kompanive të sigurimit. Sigurimi është në masën 2% të fondit limit pa TVSH. Periudha e vlefshmërisë së ofertave do të jetë sipas praktikës administrative të ndjekur 150 ditë në prokurime të ngjashme.

Në referim të nenit 39 të vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, rezulton se, kemi të bëjmë me një procedurë prokurimi ku kriteri për përcaktimin e fituesit është oferta ekonomikisht e favorshme bazuar në çmim dhe jo oferta ekonomikisht e favorshme me sistem pikëzimi, pasi në këtë rast kemi të bëjmë vetëm me punë publike që do të kryhet nga një operator ekonomik dhe sistemi i pikëzimit si rregull, vendoset për procedurat e prokurimit të cilat ndahen në lote dhe kanë karakter kompleks. Gjithashtu, vendosja e sistemit të pikëzimit është i pamundur nga vetë natyra e punëve publike.

Hapja e ofertave publike do të bëhet më datë 18.08.2023, ora 10:00. Periudha 10-ditore e pranimit të ofertave parashikohet në nenin 46 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 55 të rregullave të prokurimit publik, pasi kemi të bëjmë me një procedurë të hapur të thjeshtuar.

Në dokumentet e tenderit janë përcaktuar udhëzimet për operatorët ekonomikë, duke përfshirë këtu hartimin e ofertës, dokumentet që duhet të përfshirë në ofertë, udhëzime mbi llogaritjen e ofertës ekonomike, periudhën e vlefshmërisë së ofertës, kriteret e përzgjedhjes së ofertës fituese, korrigjimin e gabimeve dhe pjesët që mund të hiqen, ofertat anomalisht të ulëta. Udhëzimet përbajnë edhe të dhëna mbi nënshkrimin e kontratës, si njoftimi i fituesit, sigurimi i kontratës dhe njoftimi i kontratës së nënshkruar. DST-të janë hartuar me shtojcat respektive.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7).

2.1.2 Operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedurën e prokurimit nuk duhet të jenë të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik prej Agjencisë së Prokurimit Publik me masa administrative.

Argumentimi: Pika 2.1.1 është pjesë e DST-ve të hartuara gati nga Agjencia e Prokurimit Publik, mbi të cilën është punuar. Pika 2.1.2 ndalon operatorët ekonomikë që të hyjnë për të marrë pjesë kontrata të prokurimit publik nëse janë përjashtuar nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik. Një kërkesë e tillë e bën operatorin ekonomik të papërshtatshëm për të përfutur kontrata publike dhe e ndalon atë të përfutojë kontrata publike nëse është i përjashtuar nga prokurimet publike. Kërkesa gjen mbështetje në nenin 76, pika 3, shkronja “e” dhe 78 të ligjit nr. 162/2020 dhe është skualifikuese.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentet respektive për xhiron vjetore të tre viteve të fundit (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve të nenit 55 të rregullave të prokurimit publik. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga autoriteti përgjegjës për xhirot vjetore të realizuara në 3 (tre) vitet e fundit 2020, 2021 dhe 2022.

2.2.c) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim që konfirmon shlyerjen e taksave vendore pranë të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore ku operatori/operatorët ekonomik ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKR-së/QKB-së, për tre vitet e fundit

2020, 2021, e 2022, sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga njësitë administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2020, 2021 dhe detyrimet për vitin 2022, sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbyllur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar sipas vlerës së fondit limit të kësaj procedure, sipas nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, si dhe neneve 43 dhe 55, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me qëllim që autoriteti kontraktor të kuptojë nëse operatorët ekonomikë ofertues kanë apo zotërojnë mundësitë e nevojshme financiare për të përmbyllur punët publike me sukses. Xhirot e tre viteve të fundit janë 2020, 2021 dhe 2022, që rezultojnë të jenë përmbyllur edhe sipas legjislacionit tatimor. Përqindja e kërkuar mbi xhiroën vjetore është një përqindje minimale sipas RRPP-ve dhe xhiro e tre vjetëve e kërkuar, jo vetëm që përputhet me praktikën administrative të prokurimeve publike të ndjekur deri më tani, por është e rëndësishme për të vlerësuar kapacitetin ekonomik të ofertuesit dhe kuptuar nëse është i aftë financiarisht për të përmbyllur punët publike pranë autoritetit kontraktor.

Po kështu, që nga operatorët ekonomikë të vërtetohet kapaciteti ekonomik, ata mund të paraqesin kopje të bilanceve të tre viteve të fundit për vitet 2020, 2021, 2022, si mbas xhirove vjetore, të depozituar pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet, sipas ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar. Paraqitja e bilanceve është një mundësi, në rast se operatori ekonomik ofertues paraqet xhirot e kërkuara. Këto kërkesa të vendosura në DST (për mundësinë e paraqitjes së bilanceve dhe detyrimin e paraqitjes së dokumenteve për xhiroën vjetore) përputhen edhe me nenin 9 të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, sipas të cilëve periudha e raportimit financiar është 12 muaj dhe periudha e depozitimit të pasqyrave financiare është nga 12-15 muaj.

Gjithashtu, për të vërtetuar kapacitetin ekonomik, operatori ekonomik ofertues duhet të depozitojë vërtetim që konfirmon shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti lokal për tre vitet e fundit, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku ai ushtron aktivitetin sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKR-së/QKB-së. Kjo kërkesë buron nga neni 76 i LPP-së, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, sipas të cilëve subjektet tregtare kanë detyrimin që të paguajnë taksat vendore, me qëllim që të ushtrojnë aktivitetin. Vitet përkojnë me 2020, 2021 dhe 2022. Të gjitha kërkesat lidhur me kapacitetin ekonomik janë të bazuara në legjislacionin e përmendur më sipër dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse ofertuesit kanë kapacitete për të nisur dhe përfunduar punët publike që prokurohen. Po kështu, duke qenë se mund të marrin pjesë si ofertues edhe bashkime operatorësh ekonomikë, atëherë secili prej operatorëve ekonomikë të bashkuar, duhet të depozitojë dokumentacionin si më lart.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”,

të ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”; si dhe shkronjës c, të nenit 41 të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, ku parashikohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: ... c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”. Po kështu, kjo kërkesë bazohet edhe në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme në punët e realizuara, sipas nenit 55 të rregullave të prokurimit publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë vjetëve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.2 Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në punë të ngjashme operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Për kontrata/punë të ngjashme në institucione shtetërore apo ente publike të paraqitet:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr. 9, shoqëruar me:
- Kontrata e nënshkruar të sipërmarrjes;
- Situacionet përfundimtare;
- Akt-kolaudimin;
- Faturat tatimore për situacionin përfundimtar me datat, shumat dhe punët e realizuara;
- Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Për kontrata/punë të ngjashme me subjekte private në sektorin privat, të paraqiten:

- Kontratat e sipërmarrjes;

- Situacioni përfundimtar;
- Faturat tatimore për situacionin përfundimtar;
- Akt-kolaudimi për objektin;

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet, që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 20 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose në vlerën limit të kontratës për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Këto vlera janë vlerat minimale të kërkuara sipas RRPP-ve.*

Për kontrata/punë të ngjashme në institucione shtetërore apo ente publike, dokumentet si: “Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr. 9, shoqëruar me, kontratën e nënshkruar të sipërmarrjes, situacionet përfundimtare, akt-kolaudimin, si dhe faturat tatimore për situacionin përfundimtar me datat, shumat dhe punët e realizuara, si dhe certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor.

Për kontrata/punë të ngjashme me subjekte private në sektorin privat, dokumentet si: “Kontratat e sipërmarrjes, situacioni përfundimtar, faturat tatimore për situacionin përfundimtar, si dhe akt-kolaudimi për objektin, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme pranë subjekteve private, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor. Dokumentet e mësipërme janë të mbështetura edhe në legjislacionin në fuqi të zbatueshëm për ndërtimet.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, autoriteti kontraktor përveç dokumentacionit të sipërcituar, kërkon që operatori ekonomik të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar, ku të jetë e dallueshme tabela e ndarjes së punimeve midis operatorëve të bashkuar, me qëllim që të arrijë të identifikoj nëse kemi të bëjmë apo jo me punë të ngjashme të realizuara prej tij dhe sa është kjo sasi punësh. Kjo kërkesë bazohet në nenin 88 e në vijim të LPP., Po kështu, për kontratat e realizuara si nënkontraktor, autoriteti kontraktor kërkon që operatori ekonomik ofertues të paraqesë kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor, me qëllim që të kuptojë përvojën e ngjashme nga këto akte, detyrat e nënkontraktorit, si dhe nëse ajo është realizuar në mënyrë të ligjshme sipas legjislacionit të zbatueshëm në fuqi. Kjo kërkesë bazohet në nenin 89 e në vijim të LPP.

2.3.3 (Licencat) Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të vendimit nr. 42, datë 16.01.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar, që përfshin kategoritë e mëposhtme:

2.3.3.A PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

| | |
|----------|--|
| NP -1 A | Punime gjurmimi në tokë |
| NP - 7 A | Ujësjetllës gazsjellës, vajsjetllës, vepra kullimi e vaditje |

Licencat duhet të jenë të rinovuara sipas afateve ligjore e sipas modelit të lëshuar nga ministria kompetente e linjës.

Për operatorët e huaj të bëhet njësimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, për plotësimin e licencave profesionale të kërkuara lidhur me ekzekutimin e kontratës.

***Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6, shkronja a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe VKM-në nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, të ndryshuar.*

Licenca NP -1 A Punime gjurmimi në tokë;

Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Licenca NP - 7 A Ujësjetllës gazsjellës, vajsjetllës, vepra kullimi e vaditje;

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin ” e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si dhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mire të nevojshëm gjatë erdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshim në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjetllësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

2.3.4 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik.

2.3.4.A Pjesë e stafit teknik të operatorëve ofertues duhet të jenë:

- Një inxhinier ndërtimi;
- Një inxhinier mekanik;
- Një inxhinier hidroteknik;
- Një Inxhinier elektrik;

Inxhinierët e mësipërm duhet të jenë të siguar dhe të figurojnë në listëpagesat përkatëse E-Sig për 3 (tre) muajt e fundit. Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: **kontratat individuale të punës**, shoqëruar me **diplomat** përkatëse të inxhinierëve të mësipërm, si dhe **listëpagesat** për periudhen e kërkuar. Operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe jetëshkrimet (CV) e tyre.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t`u kërkuar sqarime nga AK.

2.3.4.B Operoret ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M-në nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për punonjësit e mësipërm ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- të figurojnë në listëpagesën e operatorit ekonomik për 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST-ve. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.4.C Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar staf teknik të pajisur me dëshmi profesionale/diplomë:

- Një teknik ndertimi;
- Një specialist elektrikist;
- Dy specialistë hidraulikë
- Një specialist saldator
- Dy specialistë manovrator

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës;
- certifikata/diploma profesionale per secilin prej tyre. Certifikatat/diplomat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;
- dëshmitë të vlefshme të kualifikimit dhe të sigurimit teknik, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve,
- të figurojë në listëpagesën e operatorëve ekonomikë për 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST-ve. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.4.Ç Për efekt të kryerjes së shërbimeve në tërësi, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që provon se disponon jo më pak se **18 punëtorë**, për 3 (tre) muajt prill 2023 - maj 2023 - qershor 2023, duke përfshirë këtu edhe stafin menaxherial, drejtues e teknik.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës për efekt të realizimit të punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtorë si më poshtë, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e operatorëve ekonomikë për 3 (tre) muajt e fundit) nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit

- Shofer 1 (një)
- Murator 2 (dy)
- Hekurkthyes 2 (dy)
- Karpetier 2 (dy)

Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë:

- Listëpagesat në administratën tatimore për 3 (tre) muajt prill 2023 - maj 2023 - qershor 2023;
- Vërtetim nga sigurimet shoqërore apo dega e tatimeve mbi numrin e të punësuarve që u janë paguar detyrimet dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi, për 3 (tre) muajt prill 2023 - maj 2023 - qershor 2023.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6, shkronja c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Inxhinieri i ndërtimit është i nevojshëm për shkak të objektit të punës publike që prokurohet. Pikërisht, sipas preventivit në institucion do të kryhen punime ndërtimi dhe për rrjedhojë, është i nevojshëm inxhinieri i ndërtimit. Inxhinieri mekanik nevojitet për të mundësuar konstruksionet metalike dhe montimet e pajisjeve të institucionit. Inxhinieri hidroteknik shërben për punimet ndërtimore të lidhura me me tubat e furnizimit me ujë të pijshëm.

Njësia e prokurimit çmon se, inxhinierët e mësipërm duhet të jenë të siguar dhe të figurojnë në listëpagesat përkatëse E-Sig për 3 (tre) muajt e fundit prill 2023, maj 2023 dhe qershor 2023. Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratat individuale të punës, shoqëruar me diplomat përkatëse të inxhinierëve të mësipërm, jetëshkrimet e tyre (CV), si dhe listëpagesat për periudhën e kërkuar tre mujore si më lart. Këto kritere caktohen nga njësia sepse autoriteti kontraktor duhet të ketë pranë tij të punësuar të gjithë inxhinierët e fushës si më lart, me qëllim realizimin e punimeve. Inxhinierët duhet të jenë të punësuar pranë operatorit ekonomik, me qëllim që të garantojnë mbarëvajtjen dhe realizimin e punimeve sipas grafikut të ekzekutimit dhe dokumentacioni i kërkuar për ta, provon këtë gjë dhe njëkohësisht edhe aftësitë e tyre profesionale.

Njësia e prokurimit çmon se, operatorët ekonomikë duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si; 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M-në nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për të cilin duhet të paraqitet, kontratë individuale pune, si dhe të figurojë në listëpagesa për tre muajt e fundit prill 2023, maj 2023 dhe qershor 2023. Në këtë mënyrë, operatori ekonomik me dokumentet e mësipërme provon se, e zotëron stafin e kërkuar dhe ka kapacitet teknik të plotë për të nisur dhe përfunduar punët publike, si dhe zotëron staf të përgatitur për realizimin e punëve publike. Çertifikimi i punonjësve të mësipërm shërben për realizimin e punëve publike në institucion dhe buron nga vendimi nr. 312, datë 05.05.2010 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", i ndryshuar.

Po kështu, njësia e prokurimit konstaton se, për realizimin e punëve publike sipas objektit të prokurimit, nevojitet një teknik ndërtimi, një specialist elektrikist, dy specialistë hidraulikë, një specialist saldator, dy specialistë manovratorë. Tekniku i ndërtimit nevojitet për punët ndërtimore sipas preventivit të punimeve, si dhe për punimet e prishjes. Specialisti elektrikist nevojitet për punimet elektrike dhe punimet e instalimeve të fuqisë së ndriçimit. Specialistët hidraulikë nevojiten për të realizuar punimet ndërtimore në tubacionet u furnizimit me uje te pijshem. Nevojiten dy hidraulikë sepse punimet realizohen në një kohë të shkurtër prej 30 ditësh pune, të ndara me 8 orë.. Saldatori nevojitet për punimet që lidhen me konstruksionet metalike.

. Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, autoriteti kontraktor ka kërkuar kontratën individuale të punës, certifikata/diploma profesionale për secilin prej tyre, të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dëshmitë të vlefshme të kualifikimit dhe të sigurimit teknik, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si dhe që të figurojë në listëpagesën e operatorëve ekonomikë për 3 (tre) muajt e fundit prill 2023, maj 2023, e qershor 2023, nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Kontrata individuale dhe listëpagesa e tre muajve të fundit provon se ushtrojnë detyrën pranë operatorit ekonomik që do të realizojë punimet e prokurimit publik. Certifikimet dhe dëshmitë i provojnë autoritetit kontraktor se, specialistët e fushës janë të certifikuar dhe kualifikuar nga institucione dhe organizata për këtë qëllim dhe mund të ushtrojnë detyrat, duke realizuar punët profesionalisht.

Për efekt të kryerjes së shërbimeve në tërësi, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që provon se disponon jo më pak se 18 punëtorë, për periudhën prill 2023 - maj 2023 - qershor 2023, duke përfshirë këtu edhe stafin menaxherial, drejtues e teknik. Kjo kërkesë është vendosur nga ana e autoritetit kontraktor për shkak se, punimet do të zhvillohen brenda periudhës prej 30 ditësh pune, në mënyrë efektive dhe me efikasitet, duke mos penguar aktivitetin. Numri prej 18 punëtorësh tre muajt e fundit garanton besueshmërinë e autoritetit kontraktor ndaj operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender dhe seriozitetin e tyre karshi punëve publike që do të realizojnë pranë institucionit, duke mos sjellë pengesa në drejtim të përmbushjes së detyrimeve kontraktore në të ardhmen. Numri i punonjësve nuk është diskriminues, përputhet me praktika të tjera administrative prokurimi publik dhe është proporcional me vlerën e tenderit. Numri i vendosur i punonjësve garanton seriozitetin që duhet të ofrojë një operator ekonomik për punët publike të institucionit.

Po kështu, është vlerësuar e domosdoshme, që për punonjësit të përcillen apo paraqiten, listëpagesat në administratën tatimore për secilin tre muajt prill 2023 - maj 2023 - qershor 2023

të kërkuar, vërtetim nga sigurimet shoqërore apo dega e tatimeve mbi numrin e të punësuarve që u janë paguar detyrimet mbi kontributet për po këto muaj, me qëllim që operatori ekonomik të provojë punësimin e tyre dhe kapacitetin e tij me fuqi punëtore në drejtim të përmbushjes së detyrimeve kontraktore ndaj institucionit. Për dokumentet që paraqiten me nënshkrim apo vulë elektronike, të gjeneruara nga portali elektronik e-albania, operatori ekonomik duhet të ngarkojë dokumentacionin në sistem, ashtu siç e shkarkon nga portali dhe jo të skanuar, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë dokumentacionin elektronikisht. Ky vlerësim i njësisë së prokurimit bazohet në ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, të ndryshuar dhe ligjin nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, të ndryshuar.

Punimet e ndërtimit objekt prokurimi do të kryhen në vepren e marrjes së ujit të Bargjanës që furnizon me ujë të pijshëm qytetin e Rrëshenit si dhe të gjitha fshatrat ku kalon tubacioni kryesor i dërgimit Bargjanë – Rrëshen. Distanca ndërmjet qytetit të Rrëshenit dhe vepres së marrjes së ujit në Bargjanë ku do të kryhen punimet e ndërtimit është përafërsisht 40 km, rrugë e cila nga qyteti i Rrëshenit deri në Fan (Rruka e Kombit) është për rreth 35 km, ndërsa nga dalja e autostradës ë Fan deri në Bargjanë është përafërsisht 10 km., rrugë e cila është me terren malor, të pjerrët dhe e pa asfaltuar.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:

| Nr | Mjete/pajisje teknike | Sasia | Gjendja |
|----|--|--------|------------------------|
| 1. | Kamionçinë vetëshkarkuese me kapacitet deri në 8 ton | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 2. | Eskavator me çekiç me zinxhir | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 3. | Fadromë me kapacitet deri në 2 m ³ | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 4. | Motorsaldatriçe | 1 copë | Në pronësi ose me qera |
| 5. | Kamion me vinç me kapacitet deri në 8 ton | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 6. | Montorbetoniere | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 7. | Vibrator | 2 | Në pronësi ose me qera |

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Ofertuesi ekonomik i kualifikuar në vend të parë, para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për makineritë, që janë në pronësi ose me qira, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi duhet të paraqitet:
 - dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
 - lejen e qarkullimit;
 - certifikata e vlefshme e kontrollit teknik;
 - siguracionin (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit deri në përfundim të punimeve;

- *lejen e transportit që lëshohet nga njëسيا vendore dhe fotot përkatëse .*

Kur mjetet janë me qira, duhet të paraqitet edhe kontratë qiraje e vlefshme deri në përfundim të punimeve.

- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:
 - *Kontrata e shitblerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse;*
 - *Fotot*

Kur mjetet janë me qira, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e vlefshme deri në përfundim të punimeve..

Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar, ku të jetë e dukshme edhe targa e mjetit. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se, makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera publike apo në procedura të tjera ku ai është shpallur fitues. Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendqëndrimin e mjeteve dhe makinerive, me qëllim që autoriteti kontraktor të ketë mundësinë që t'i verifikojë në çdo moment. Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojta për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kamionçina me vetëshkarkuese me kapacitet deri në 8 ton;

Kamionçina duhet jo vetëm për transportimin e materialeve të ndërtimit, por edhe për pastrimin e vendit të punës, si edhe mbetjeve që do të rezultojnë nga punime prishjesh. Kamionçina deri në 8 tonë duhet edhe për mbajtjen e materialeve të punimeve të ndërtimit. Kamionçina duhet deri në 8 ton, pasi mund të qarkullojë në rrugen me terren malor të vështirë, pa probleme, një kamionçinë me kapacitet më të madh se 8 ton e ka shumë të vështirë të qarkullojë në rrugën e pa asfaltuar malore prej afërsisht 10 km të ngushtë dhe me vende me terren të vështirë.

Eskavator me çekiç me zinxhirë;

Eskavatori me çekiç me zinxhir është i nevojshëm për punimet e ndërtimit që do të kryhen jo vetëm për pastrimin dhe copëtimin e gurëve dhe terrenit në disa pjesë të rrugës malore, të pa asfaltuar prej afërsisht 10 km por dhe është i domosdoshëm për prodhimin dhe copëtimin e gurëve të cilët do të përdoren për realizimin e punimeve në veprën objekt prokurimi.

Fadromë me kapacitet deri në 2 m³ ;

Fadroma me kapacitet deri në 2m³ shtë e nevojshme për transportin, afrimin dhe hedhjen e materialeve të ndërtimit gjatë punimeve, si gurë, çakull, rërë e çdo material tjetër të nevojshëm për realizimin e punimeve të ndërtimit. Është thkesuar që fadroma të jetë deri në 2 m 3 për faktin se fadroma me këtë kapacitet mund të operojë në terrenin shumë të kushtëzuar ku do të kruhet punimet e ndërtimit. Një fadromë me kapacitet me të madh do ta ketë shumë të vështirë ose të pamundur të kryejë veprimet operuese në atë terren.

Montorsaldatriciç:

Motorsaldatriciça, është specifikuar motor saldatriciçe sepse në zonen ku do të kryhen punimet e ndërtimit nuk ka energji elektrike, motorsaldatriciça është e domosdoshme për kryerjen e punimeve në konstruksione metalike, në mënyrë të domosdoshme në tubacionet prej çeliku të cilat do të përdoren për realizimin e punimeve të ndërtimit në vepren e marrjes së ujit të pijshëm Bargjanë, Njësi Administrative Fan, Bashkia Mirditë.

Kamion me vinç me kapacitet deri në 8 ton;

Kamioni me vinç nevojitet për punët ndërtimore në vendin e kryerjes së punimeve të ndërtimit, për zbritjen dhe mbajtjen e materialeve të ndërtimit pezull si: dërrasa, hekur, gurë, zhavor, çimento, etj si dhe mbajtjen e konstruksioneve metalike dhe tubacioneve gjatë punimeve, saldimit e montimit të materialeve, punime dhe veprime të cilat nuk mund të kryhen nga punëtorët apo ndonjëra nga makineritë e kërkuara nga AK në këtë procedurë prokurimi. Është kërkuar kapaciteti jo më shumë se 8 ton, pasi siç e theksuam dhe për makineritë e tjera, terreni në kantierin e ndërtimit të kësaj vepre është i vështirë dhe shumë i kufizuar dhe me pjerrtësi të madhe.

Montorbetoniere;

AK ka kërkuar motorbetoniere sepse në vendin ku do të kryhen punimet e ndërtimit nuk ka energji elektrike, betoniera është e domosdoshme për përgatitjen e betonit dhe materialeve të tjera për ndërtim. Pasi gjatë këtyre punimeve ky proces është voluminoz dhe sipas standarteve teknike.

Vibrator;

Vibratori do të përdoret për vibrimin e punimeve gjatë betonimit, proces i cili është i nevojshëm dhe i domosdoshëm për te siguruar cilësinë e punimeve të betonit, të cilat do të kryhen në këtë vepër, objekt prokurimi.

Makineritë dhe mjetet e disponuara me qira, të dokumentohen me kontratë qiraje të vlefshme, të lidhur para noterit, ndërsa ato në pronësi me dokumentin e pronësisë. Kontrata e qirasë për mjetet dhe makineritë të jetë e vlefshme ose shtrihet deri në përfundim të kryerjes së punimeve që do të prokurohen. Ky kriter vendoset nga njësia e prokurimit për të vërtetuar kapacitetin e operatorit ekonomik dhe mbarëvajtjen e punimeve.

Për mjetet që janë të regjistruar në regjistrat publikë të paraqiten dokumenti që vërteton pronësinë, certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik të mjetit, siguracionin e vlefshëm deri në përfundim të punimeve, lejen e transportit që lëshohet nga njësia vendore. Mjetet duhet të jenë të shoqëruara me fotot respektive. Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat e pronësisë paraqitet kontrata e shitblerjen, faturat tatimore ose fatura

e zhdoganimit, Kërkesat e mësipërme për kapacitetin teknik janë bazike dhe janë në përputhje me praktikën administrative që ndjekin edhe procedura të ngjashme prokurimi.

2.3.6 Operatori ekonomik paraqet vetëdeklarim, se brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer nga çasti i shpalljes fitues, e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

Argumentimi: *Kjo kërkesë është vendosur nga autoriteti kontraktor, me qëllim që operatori ekonomik të jetë plotësisht i dedikuar punimeve sipas prokurimit publik pranë institucionit tonë. Deklarata duhet të paraqitet pranë institucionit së bashku me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas formatit të mëposhtëm.*

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS

(Për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

| Nr. | Autoriteti kontraktor | Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës | Vlera e shpallur fituese |
|------------|------------------------------|--|---------------------------------|
| | | | |
| | | | |

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi: *Autoriteti kontraktitor kërkon që dokumentacioni që do të depozitohet pranë institucionit përpara lidhjes së kontratës, duhet të jetë origjinal ose i noterizuar. Nëse një dokument është i pasaktë, i mungojnë elementë vlefshmërie ose është fals, operatori ekonomik skualifikohet dhe njoftohet Agjencia e Prokurimit Publik.*

Njësia e Prokurimit:

Aida Camaj

Flora Gjini

Bora Kolbuçaj